



Peaceful
Change
initiative



Gratë në media

Anketa Serbi

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Gjetjet kryesore	4
Profili i të anketuarave	5
Mosha e të anketuarave	6
Puna dhe të ardhurat	7
Pabarazia në të ardhura: “Gjithmonë ka ekzistuar”	8
Pamja si kriter: “Të veshura me xhinse të ngushta”	9
Paragjykimi/diskriminimi për shkak të moshës: “Dukem më e re”	10
Ngacmimi seksual: “Pritje të caktuara?”	11
Flirtimi dhe të tjera: “Në fakt asgjë e veçantë”	14
Perceptimi personal: “Ata jetojnë rreth meje”	16
Portreti i grave në media: “As që e vërejnë se nuk janë të pranishme”	22
Rekomandime	26
Mirënjohjet	27
Metodologjia	27
Rreth ALVED-it	28
Rreth PCi	29

HYRJE

Gjatë periudhës nëntor 2020 dhe dhjetor 2022, Iniciativa për ndryshim paqësor (Peaceful Change initiative – PCI) mbajti një seri dialogjesh konsultative të mediave (Media Consultation Dialogues) ku morrën pjesë shumë profesionistë të medias nga Kosova dhe Serbia. Në dhjetor të vitit 2021, ne organizuam Dialogun Konsultativ të Mediave për “Gratë nëpër redaksi”. Ne i bëmë bashkë një grup gazetarësh kosovarë dhe serbë, në një format online, për t’i dëgjuar reflektimet e tyre lidhur me pozitën e grave në media, statusin e tyre, mundësitë për avancim, çështjet specifike që lidhen me gjininë si: dhuna seksuale në vendin e punës dhe se si e perceptojnë ata(o) përfaqësimin gjinor në media.

Takimi u zhvillua kur pandemia COVID-19 ishte ende një pjesë e ngatërruar e jetës, punës, aktiviteteve dhe e diskutimeve tona të përditshme. Tashmë ne ishim dëshmitarë se si virusi i përkeqësoi më tej pabarazitë, pasi që shumë nga përvojat e fshehura të krizës ishin të aspektit gjinor: duke filluar nga rritja e barrës së punës së papaguar e deri tek rritja e numrit të rasteve të dhunës me bazë gjinore. Po ashtu, ishte koha kur ishim dëshmitarë se si gratë qenë në vijën e parë të frontit kundër pandemisë, si arkëtarët nëpër dyqanet ushqimore dhe infermieret në kujdesin shëndetësor. Në mesin e atyre që ishin në vijën e parë të frontit ishte edhe një grup i veçantë: gazetaret gra, që raportonin për virusin që nga koha e shpërthimit të tij.

Prania në ekran e reportereve gra konfirmoi edhe një herë diçka që punëtorët e mediave tashmë e kanë thënë brenda rrethëve të tyre: se gratë përbëjnë shumicën e gazetarëve në terren në Serbi. Megjithatë, redaksitë në Serbi jo vetëm që nuk arritën ta përdornin fuqinë dhe ndikimin e tyre për t’i sfiduar normat tradicionale sociale dhe kulturore që e vazhdojnë në pambarim shtypjen e grave, por shpesh përfundojnë duke i përforcuar dhe mirëmbajtur perceptimet dhe stereotipet e dëmshme gjinore.

Kjo gjë u sugjerua edhe nga gazetaret gjatë diskutimit ku u theksua fakti se si redaksitë nuk po arrijnë t’i përfshijnë perspektivat, përvojat dhe zërat e grave në produksionet e tyre mediale. Por theksuan se redaksitë po dështojnë edhe me to, pasi që pabarazia gjinore dhe seksizmi nuk janë vetëm pjesë e titujve, por edhe e vendit të tyre të punës.


Ky raport rrjedh nga vetë pjesëmarrëset, të cilat shprehën nevojën për një anketë që do të përqendrohej në pozitën e grave në media dhe që do të ofronte një pasqyrë më të mirë të (pa) barazisë gjinore nëpër redaksi.

Shpresojmë që gjetjet e kësaj ankete do të hapin rrugën për këtë bisedë.

GJETJET KRYESORE:

- **41.4 përqind** e grave të anketuarave fitojnë më pak se mesatarja kombëtare
- **40 përqind** e tyre punojnë 40 ose më shumë orë në javë
- **34.9 përqind** konsiderojnë se për punë të njëjtë fitojnë më pak se kolegët e tyre burra
- **26.5 përqind** kanë qenë të diskriminuara për shkak të pamjes së jashtme, ndërsa **36 përqind** për shkak të moshës
- **29.1 e të anketuarave** kanë qenë viktima të ngacmimit seksual
- **42.7** ndjejnë se jeta e tyre private ka pësuar për shkak të punës, ndërsa 24 përqind mendojnë se jeta private ndikon shumë në punën e tyre.
- **46.1 përqind** konsiderojnë se gratë janë më pak të përfaqësuara se burrat në përmbajtjet mediale



Ndoshta gjetja më ilustruese është se 41.2 përqind e të anketuarave nganjëherë, e 27.8 përqind e të anketuarave shpesh **mendojnë që ta ndërrojnë vendin e punës** - kjo në fakt nënkupton se për një arsye ose një tjetër, gati 70 përqind e grave të angazhuara nëpër redaksi janë të pakënaqura me profesionin e tyre ose me punën që bëjnë.



Në përgjithësi, të gjitha këto gjetje janë në përputhje me hulumtimet periodike globale mbi statusin e grave në media, që tregojnë përfaqësim të pabarabartë në pozitat drejtuese dhe në përmbajtjet mediatike, pamundësinë për të përshtatur jetën private dhe karrierën, si dhe diskriminimin. Ajo që i jep një “ngjyrë” të veçantë këtij hulumtimi u shpëton statistikave – në pyetje janë dëshmitë tronditëse rreth abuzimit seksual, pakënaqësisë, ndjenjës së mospërbushjes në këtë fushë apo tjetër, të cilat edhe po i ndajmë dhe përcjellim këtu pjesërisht.


PROFILI I TË ANKETUARAVE

Në radhët e të anketuarave të përfshira kishte gazetare, fotoreportere, lektore, montazhere, redaktore, kryeredaktore, drejtoresha dhe drejtuese të punësuar në të gjitha llojet e mediave.



MOSHA E TË ANKETUARAVE

Përfaqësimi i moshës së të anketuarave është po aq reprezentative - shumica e tyre janë të moshës prej 18 deri në 21 vjeçare, por ka edhe gra të moshës së mesme dhe pensioniste.




Në mesin e të anketuarave janë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë gra me vetëm 5 deri në 10 vjet përvojë pune në media, si dhe gra me më shumë përvojë.

Gati një e treta e të anketuarave në media e përcjellin politikën, 14,4 përqind e përcjellin kulturën, 6,8 përqind ekonominë, dhe vetëm 5,3 mbulojnë rubrikat e shoubizit dhe modës – që dikur ishin “streha të sigurta” të grave në media. Kjo e ilustron tendencën tashmë të dukshme të grave që lëvizin drejt segmenteve mediatike më fitimprurëse dhe me prani më të dukshme.




PUNA DHE TË ARDHURAT

Në 41,4 përqind të rasteve, paga e të anketuarave është më e ulët se mesatarja për Republikën e Serbisë, që në kohën e hulumtimit zyrtarisht ishte 75,282 RSD – ose 627 euro. Madje 13.6 përqind e të anketuarave kanë të ardhura përgjysmë më të ulëta se mesatarja kombëtare, ndërsa gjithsej 45 përqind e të anketuarave kanë të ardhura më të larta se mesatarja.




Dallimet në të ardhura kryesisht vijnë nga pozitat e ndryshme të mediave në treg, por ndoshta edhe nga dallimet sa i përket numrit të orëve të punës, që korrespondon me dallimet në të ardhura.



PABARAZIA NË TË ARDHURA: “GJITHMONË KA EKZISTUAR”

Kur u pyetën nëse për arsye se janë gra, ato fitojnë më pak se kolegët e tyre burra, më shumë se një e treta e të anketuarave u përgjigjën me po. Edhe pse shumë më shumë të anketuara kanë një pikëpamje të ndryshme, kjo ende devijon nga perceptimi i zakonshëm se gratë në Serbi - pavarësisht formave të ndryshme të diskriminimit, prapëseprapë nuk janë të pabarabarta sa i përket të ardhurave.




Dëshmitë:

Sa i përket raportit të burrave dhe grave në redaksi, përvoja ime thotë se ata GJITHMONË kanë pasur paga më të larta për të njëjtat punë. Kurrë nuk do ta kem të qartë se pse është kështu! Gjithashtu, kur pranohen bashkëpunëtorë të rinj, meshkujt janë gjithmonë më të mirëpritur...

PAMJA SI KRITER: “TË VESHURA ME XHINSE TË NGUSHTA”

Në 26.5 përqind të rasteve, të anketuarat deklarojnë se janë diskriminuar gjatë karrierës së tyre për shkak të pamjes së tyre. Dëshmitë janë të ndryshme, disa prej tyre mjaft dramatike – praktikisht “mbështillen” me ngacmime seksuale, por të gjitha kanë një mendim të përbashkët se pamja e jashtme ka ndikim në karrierën e tyre në media.



Dëshmitë:

Komentet për pamjen dhe moshën time kanë qenë të shpeshta. Edhe pse supozohej të ishin komplimente apo shaka “të pavend”, unë ndihesha gjithmonë në siklet. Dikur kisha një redaktore që këmbëngulte që të shikoja fotot e saj nudo nga një album privat që ajo kishte sjellë në redaksi. Ndihesha tmerrësisht keq sepse e dija se ajo po e bënte këtë sepse e dinte se nuk ndihesha rehat dhe donte të më përulte. Këtë gjë duhej ta shikonin edhe 2 kolege të tjera femra.

Një koleg kameraman më tha që në moshën time duhet të jem në xhinse të ngushta.

Për fat të keq, pamja e jashtme është shpesh më e rëndësishmja. Edhe se arsimimi, ekspertiza...

Ka “media” në të cilat gazetaret dhe prezantueset femra duhet të duken si personazhe të shoubizit/ estradës për të pasur një shans.


Në redaksinë ku jam aktualisht nuk e kam vënë re se ka tendencë për të caktuar detyra të caktuara sipas gjinisë. Megjithatë, në kompaninë televizive ku kam punuar për vite me radhë, një shembull i kësaj është se nuk do të shihni asnjë mashkull që bën, për shembull, parashikimin e motit, kjo detyrë zakonisht u jepet vajzave të reja me pamje të këndshme, sërish, pavarësisht ekspertizës dhe përvojës

Të gjitha komplimentet për pamjen e jashtme në punë i konsideroj si të papërshtatshme. Në media, veçanërisht në TV, ndodh shpesh që gazetaret (të reja) të bëhen objekte dhe që konsiderohet krejtësisht mirë kur një redaktor apo koleg të komentojë për ju në këtë kuptim. Konkretisht, kam pasur një ftesë nga redaktori për ta shoqëruar në një projekt ku ishte i ftuar vetëm ai. Unë refuzova, kështu që u ndëshkova me punë shtesë dhe tallesha dhe ngacmohesha nga të gjithë.

PARAGJYKIMI/DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË MOSHËS: “DUKEM MË E RE”

Diskriminimi për shkak të moshës vihet re nga më shumë se një e treta e të anketuarave, duke e lidhur shpesh me diskriminimin në bazë të pamjes. Në këtë kuptim, vëzhgimi i një të anketuare është domethënës se “diskriminimi për shkak të moshës është i ndërsjellë, si ndaj grave të reja, ashtu edhe ndaj më të moshuarave”. Siç theksojnë bashkëbisedueset, gazetaret më të reja gra nuk perceptohen si të zgjuara dhe serioze, ndërsa shikuesit nuk kanë shumë dëshirë t’i shohin ato më të vjetrat në televizion.

Nga komentet për pyetjet e tjera, të krijohet përshtypja se paragjykimi/diskriminimi për shkak të moshës disi është “normalizuar” dhe se me këtë nënkuptohet që disa punë në media janë të rezervuara për gra më të reja e disa për gra më të vjetra.



Dëshmitë:

Një problem shumë i madh për femrat e reja që duan të merren seriozisht me gazetari është se bashkëbiseduesit/meshkujt nuk i marrin seriozisht, domethënë nuk duan të thellohen dhe t’u përgjigjen pyetjeve në të njëjtën mënyrë sikur flasin me një mashkull. Kjo është veçanërisht e dukshme kur bëhet fjalë për drejtorët e kompanive publike, avokatët, zyrtarët dhe të ngjashme.


Bashkëbiseduesi juaj gjithnjë preferon të flasë me një femër më të re se me një më të vjetër sepse mendon se mund ta manipulojë sepse “ajo nuk ka haber”. Kur një grua ndërton karrierë, nuk e ka më atë problem.

Kam filluar të punoj shumë e re dhe i përkas grupit të femrave “tipikisht” tërheqëse, po ashtu duken edhe më e re se sa jam, ndaj bashkëbiseduesit më kanë nënvlerësuar shpesh, gjë që më ka qenë e dobishme për një kohë të gjatë në kuptimin që janë “çelur” më lehtë me mua dhe shpeshherë nuk i kushtonin kujdes atyre se çfarë thonin para meje.

NGACMIMI SEKSUAL: “PRITJE TË CAKTUARA?”

Kur iu përgjigjën pyetjes për ngacmimin seksual, 29.1 përqind e të anketuarave deklaruan se e kishin përjetuar atë. Edhe pse 70.9 përqind e atyre që përgjigjen negativisht, fakti se gati një e treta e të gjitha të anketuarave e kanë përjetuar personalisht këtë formë dhune është shumë shqetësuese dhe të çon në përfundimin se gazetaria është një profesion i rrezikshëm për gratë.

Duke gjykuar nga dëshmitë, gratë ngacmohen njëllë në terren, në punë, dhe në redaksi - ku dhuna ushtrohet nga kolegët e tyre burra, madje edhe gjatë studimeve për gazetari. Veçanërisht problematik është fakti që këto raste më së shpeshti nuk procedohen institucionalisht, madje as nuk raportohen. Të anketuarat zakonisht jepnin dorëheqje, prisnin “të kalonte kjo”, ose - siç thuhet në njërin nga dëshmitë, deri sa gjenin një “mik të përbashkët falë të cilit ndalej ngacmimi verbal”.



Dëshmitë:

Bashkëbiseduesi më komentoj se si isha veshur, më tha se dukesh seks. Ai më puthi dorën. Më vonë ai më telefonoi, e përfundoi bisedat me “ju puth”...

Ngacmimi verbal në redaksinë ku punoja ishte pjesë e argëtimit dhe shakasë. Unë këtë e shihja si maltretim deri në atë masë sa nuk doja të shkoja në redaksi.

Një herë organizatori më ndoqi nëpër redaksi dhe tha se do të vriste veten nëse nuk do të ishte me mua.

Një person mashkull me të cilin e zhvillova intervistën më dërgonte mesazhe eposh ndjellëse dhe me këmbëngulje përpiquej të më “gjuante” e të më nxirrte në një takim. Mashkulli tjetër me të cilin e zhvillova edhe intervistën më ofroi me këmbëngulje një pije dhe e gjithë situata ishte e pakëndshme, sepse ai po përpiquej të më “gjuhej”.

Çdo koment i papërshtatshëm nga një koleg i vjetër, vërsimi i syve, përqaftime të panevojshme dhe prekje të tjera gjoja spontane mund të interpretohen si një formë abuzimi. Kishte disa situata të tilla dhe isha shumë në siklet.

Nje mbërthim fizik i papritur nga zv/kryeredaktori sa të mos mund të lëvizja dot as një milimetër dhe tentativa për të kryer një “puthje të thellë”, derisa në pak sekonda kuptova se çfarë po ndodhte dhe nisa ta mbroja fizikisht veten... Disi ia dola.

Redaktori më bëri komente të papërshtatshme dhe kjo u përshkallëzua kur më dërgoi një foto të organit të tij gjenital. Pasi ia tërhoqa vërejtjen për sjelljen e tij, mora përgjigjen “ai është i tillë”, dhe redaktorja që duhej të më mbronte i tha atij që e kam denoncuar.

Drejtori të cilin e refuzova më ofendoi, më goditi dhe më pushoi nga puna.

Për muaj të tërë, një koleg, duke pretenduar se kishte rënë në dashuri, më ngacmonte praktikisht, kryesisht verbalisht. Kjo ndodhi në fund të viteve nëntëdhjetë, kur kishte edhe më pak mekanizma për zgjidhjen e problemeve të tilla.

Një koleg më goditi në të pasme gjersa po merrja kasetat për inçizim, duke thënë se e tërhoqte fundi im i shkurtër. Një koleg tjetër më mori pëllëmbën dhe në bazë të disa interpretimeve të tij në dhomën përballë kolektivit më tha se duhet të jem e mirë në seks.

Eprorët e mi më shantazhonin se nuk do të punësohesha asnjëherë nëse nuk i plotësoja kushtet e tyre.

Redaktori i injoroi idetë e mia dhe e nënçmoi punën time pasi refuzova një marrëdhënie intime me të.

Në vitin 1997, shefi i korrespondencës u përpoq të më tërhoqte në shtrat, më duhej të lija punën.

Redaktori kishte disa pritshmëri, nevojë për “chat” dhe shoqërim jashtë orarit të punës dhe kur unë refuzoja diçka të tillë në koleg, ai gjente arsye për të cilat do të më kritikonte para të gjithëve...

Ishte ngacmim seksual nga një koleg. Nuk ishte e vazhdueshme. Në nivelin e pamjeve të vazhdueshme, të cilat nuk janë të këndshme. Kulmi ishte kur ai më përqafoi nga pas dhe më puthi në qafë, duke e shpjeguar këtë me atë se ai e kuptoi që unë e doja.

Prekje të papërshtatshme, aludime seksuale, dy herë edhe biseda shumë të pakëndshme (nuk e kupton çfarë do të thotë “nuk jam i interesuar”) në redaksinë pasi të gjithë shkuan në shtëpi.

Një koleg nga një redaksi tjetër bëri komente të papërshtatshme seksuale dhe u soll në mënyrë të papërshtatshme. Kur ia bëra të qartë se nuk mund të sillej kështu, filloi të botonte tekste në të cilat më shante dhe më diskreditonte mua dhe bashkëpunëtorët e mi.

Një ftesë publike që të shkoja në zyrë për të parë se sa i veçantë ishte ushtruesi i detyrës së drejtorit, që të shkruaja sa më mirë për të.

Një kolegë më komentoj gjoksin në mes të redaksisë.

Redaktori më kërcënoi se do të më largonte nga profesioni nëse nuk do të bëja seks me të.

Një idiot, asokohe redaktor në radiostacionin ku punoja me kohë të pjesshme si maturante, më hodhi në një zyrë bosh dhe u përpoq të më hidhte mbi tavolinë. Unë mbrojta veten.

Unë isha shumë më e re, drejtori dhe redaktori përgjegjës me të njëjtin personalitet më sulmoi fillimisht në mënyrë vulgare, më pas më ofendoi, më goditi dhe më pushoi nga puna.

Pronari i medias hidhte lloj-lloj komente seksuale ndaj gazetaresve të reja në redaksi, arriti deri aty sa në mes të verës njerëzit të vinin në punë me pantallona dhe këmba të gjata.

Një koleg i moshuar, organizator i udhëtimit studimor, fillimisht filloi të më prekte në mënyrë të papërshtatshme dhe më pas hyri në dhomën time gjatë mbrëmjes. Mezi e nxora atë dhe përfundova duke mos qenë në gjendje ta realizoja storien.

Disa bashkëbisedues (politikanë) ishin imponues.


Në një rast, dikush më ka fotografuar në terren dhe fotografia ime është publikuar në faqen e Instagramit përmes së cilës gjenden njerëzit, kështu që disa i kanë shpërndarë të dhënat e mia personale.

Kam përjetuar që një koleg më i vjetër ishte imponues ndaj meje, fillimisht më ofroi punë dhe u tregua i sjellshëm dhe më vonë kur dolën të gjithë më preku kokën dhe më puthi në fytyrë pa pëlqimin tim dhe pavarësisht se u përpoqa të largohesha.

Fatkeqësisht, komentet seksiste të bashkëbiseduesve janë pjesë e përditshmërisë së çdo gazetaresve.

FLIRTIMI DHE TË TJERA: “NË FAKT ASGJË E VEÇANTË”

Dy të tretat e të anketuarave deklarojnë se nuk kanë përdorur kurrë ndonjë metodë joshjeje apo flirtimi në punën e tyre, ndërsa vetëm 2.1 përqind e tyre i kanë përdorur këto metoda në disa raste. Mirëpo, shqetësuese është dëshmia në të cilën thuhet se “gazetarët nxiten që të kultivojnë kontakte jashtë orarit të punës duke dalë për kafe e të ngjashme”. Ky nuk është vetëm një kërcënim i drejtpërdrejtë për sigurinë e gazetareve gra (“... një zyrtar lokal e keqinterpretoi këtë dhe më sulmoi në mënyrë të vrazhdë kur u pamë. Unë nuk bëra kallëzim, sepse ai është edhe oficer policie i rangut të lartë”), por kjo është në kundërshtim me parimin e objektivitetit dhe pavarësisë së medias.



Dëshmitë:

Ka të bëjë më shumë me sharmin dhe elokuencën sesa me atributet, nuk e kam përdorur kurrë këtë.

Një buzëqeshje, asgjë më shumë.

Për fat të keq, tek femrat, dashamirësia shpesh keqpërdoret dhe keqinterpretohet. Kështu që besoj se kam arritur të realizoj disa intervista sepse jam grua, që është një lloj diskriminimi pozitiv, derisa kjo të mos sjellë me vete ngacmime me fjalë.

Dilja nëpër darka.

Flirtimi për të marrë një intervistë.

Një koleg duhej të bënte një intervistë. Ai e dinte që bashkëbiseduesi nuk do të më refuzonte, ndaj më nxiti të caktoja një intervistë.

Vishem bukur, e rregullt, më pëlqen të dukem moderne.

Dikur isha më dashamirëse se zakonisht, sepse doja të fitoja një bashkëbisedues. Asgjë më tej se kaq.

Sepse shpesh është mënyra e vetme për të komunikuar me një lloj të caktuar pjesëtari të gjinisë të kundërt.

Plotësisht në mënyrë të pafajshme, por e dija që dikush kishte simpati ndaj meje dhe kaq. Unë e merrja një deklaratë, të tjerët jo.

Nëse është me të vërtetë e rëndësishme për ju që të mos vini në siklet kompaninë mediatike, ju jeni shumë të mirë me të ftuarin, vetëm për shkak të kompanisë mediatike.

Në mënyrën sa më pa dhimbje të mundshme, me një buzëqeshje apo pak më shumë dashamirësi.

Epo, jo drejtpërdrejt, por nëse do të vëreja se një burrë tregon një lloj interesi, do të isha shumë dashamirëse, ndonjëherë pija ndonjë pije me të, por kurrë asgjë më shumë.

Me fjalë dhe sharm, e bindnja bashkëbiseduesin të pranonte intervistën, duke e ditur se nuk kishte kohë.

Më është dashur t'i "zbusja" disa herë bashkëbiseduesit me një buzëqeshje ose një fjalë "më të butë".

E bëja, duke u shtirur se kisha pasiguri dhe dobësi.

Asgjë e veçantë në të vërtetë, thjesht po përfitoja nga fakti i të qenit grua.

Isha shumë më e këndshme, aq sa nuk është në natyrën time.

Me aftësitë e mia negociuese e bëja bashkëbiseduesin më në dispozicion.

Këto janë gjëra më të pavetëdijshme që një grua bën në komunikimin e përditshëm.

Këto kryesisht janë janë koketime të vogla.

Nuk jam gazetare, por ne përgjithësi më ka ndodhur të përdor sharmin për të kryer sa më shpejt një punë, pavarësisht nëse i kam kërkuar një shërbim/informacion një femre apo mashkulli.

Epo, unë jam elegante, menjëherë shihen të gjitha atributet.

Më shumë ka të bëjë me marrjen e informacionit për shkak të një njohjeje të mëparshme jashtë kësaj pune, sesa për shkakun se jam gazetare.

Burrat shpresojnë për kontakt të mëtejshëm nga një gazetare tërheqëse.

Mbi të gjitha, aftësi të mira komunikimi

Më dashamirëse se zakonisht në marrëdhëniet e ftohta me bashkëbiseduesit

Unë thjesht vishem më elegante sesa në një ditë normale në punë.

Sharmin e përdorin si meshkujt ashtu edhe femrat, andaj nuk mendoj se jemi më specifike në këtë

Bashkëbiseduesit meshkuj shpesh e refuzojnë kolegun tim, por kur unë u telefonoj, mua nuk më refuzojnë, kështu që ne e përdorim këtë, për fat të keq, për të arritur tek bashkëbiseduesi.

Nuk e di nëse me këtë nënkuptohet të jesh tepër i sjellshëm edhe kur biseda është jashtëzakonisht e pakëndshme. Mendoj se kjo është arma ime më e fortë sepse di të qëndroj e qetë edhe në situata shumë të pakëndshme dhe ta "zbut" bashkëbiseduesin. Por përsa i përket veshjeve, etj. Asnjëherë nuk e kam theksuar kurrë femnilitetin tim për të marrë përgjigje.

PERCEPTIMI PERSONAL: “ATA JETOJNË RRETH MEJE”


Pyetjet për sakrificat për hir të punës, rreth gjetjes së balancës mes jetës private dhe punës në media, tregojnë me të vërtetë se sa e komplikuar është pozita e gruas nëpër redaksi. Në mungesë të hulumtimeve në të cilat burrat u përgjigjen pyetjeve të ngjashme, ne nuk mund të pretendojmë për pabarazi, por kjo sigurisht ilustron problemet e mëdha dhe gati të pazgjidshme me të cilat ballafaqohen bashkëbisedueset tona dhe koleget e tyre gra në një mjedis patriarkal.

Edhe pse vetëm 12.6 % e të anketuarave nëna besojnë se karriera e tyre ka pësuar për shkak të mëmësisë, deri në 42.7 % thonë se jeta e tyre private shpesh ka pësuar për shkak të punës, dhe 35.2 % se kjo ka ndodhur ndonjëherë – d.m.th., në përgjithësi, se në media, jeta familjare dhe private ka pësuar në gati 80 % të rasteve.

Situata është disi e ngjashme kur i pyetëm se sa ka pësuar angazhimi profesional për shkak të detyrimeve familjare: 45,9 % vlerësojnë se ka ndodhur “pak”, dhe 24 % se ka ndodhur “shumë”: në total, arrijmë në 70 % të të anketuarave që mendojnë se obligimet familjare ndikojnë deri në masë të caktuar në karrierë.

Përgjigja në pyetjen për mundësinë e shkurtimit të orarit të punës për gratë-nënat apo mungesën gjatë sëmundjes së fëmijës është shumë ilustruese. Ndërsa 46,7 % e të anketuarave u përgjigjen se e kanë këtë mundësi, 11,7 % se nuk e kanë, 41,7 % thanë se kjo zonë është ende “në zonën gri” dhe se kjo varet nga vullneti i mirë i dikujt. Përgjigja e tyre është: “Sipas marrëveshjes, varet nga situata”. Kjo do të thotë se në aspektin e përditshëm, një grua duhet të kujdeset për një “situatë” të mundshme, të “mos mbajë mëri” dhe në këtë mënyrë ta ruajë e forcojë marrëdhënien tashmë ekzistuese të pushtetit në redaksi.

Veçanërisht indikative se pikërisht në këtë segment të anketuarat u “hapën” më shumë dhe treguan historitë e tyre: se për shkak të shtatzënive u ndërpreu karrierat, për shpërblimet që nuk i morën sepse iu përkushtuan familjes, për marrjen e fëmijëve në punë, por edhe për keqardhjen se për shkak të punës nuk i kanë vizituar të afërmit në spitale, se për shkak të punës janë divorcuar ose kanë pasur aborte ...




13

Sa ndikojnë obligimet tuaja familjare në angazhimin tuaj profesional?

24.0%
Shumë

45.9%
Pak

30.1%
Aspak




14

Nëse jeni e martuar ose nënë, a e keni ndjenjën se karriera juaj ka pësuar për shkak se jeni e martuar ose nënë?

87.4%
Jo

12.6%
Po



15

Në redaksinë tuaj, a ekziston mundësia e orarit të shkurtuar të punës për gra-nëna ose e mungesës në punë për shkak të sëmundjes së fëmijës?

11.7%
Jo

46.7%
Po

41.7%
Me marrëveshje, varet nga situata



Dëshmitë:

Në pushim të lehonisë, paga ime nuk ishte e barabartë me ndryshimet e kolegëve të tjerë. Zgjodha të punoja në një gazetë javore që gjatë moshës më të vogël të fëmijës të jem më shpesh me fëmijën tim ose ta çoja te mjeku pa pasur nevojë të justifikoja se ku jam gjatë orarit të punës. Kohën e humbur e kam kompensuar gjatë natës dhe kam refuzuar oferta të tjera të punës, sepse bashkëshorti im nuk e kishte mirëkuptimin e punëdhënësit që ai të merrte pushim mjekësor për hir të fëmijës. Shpesh zgjidhnin të tjerët për të shkuar në udhëtime pune dhe natyrisht, rroga e kolegëve të mi meshkuj, sidomos gjatë asaj periudhe, u rrit, ndërsa e imja mbeti e njëjtë edhe pse performanca ime ishte më e lartë, por nuk kisha mundësi të rrija në kafene e të shoqërohesha pas punës

Nxitoja për në shtëpi nga puna dhe të tjerët marrin përfitonin shanse

Mund të kisha përparuar shumë më tepër, por kjo do të nënkuptonte të punoja më shumë orë, të cilat nuk mund t'i përballoja me fëmijët, pasi para së gjithash jam nënë.

Pata dy lindje me prerje cezariene dhe komplikacione pas tyre, u detyrova të lija punën në mediat klasike dhe të filloja punë të pavarur nga shtëpia.

Koha që i kushtoja fëmijës e pakësonte kohën që mund t'i kushtoja punës. Rezultati është pamundësia për të investuar kohë për angazhim shtesë në punë dhe për të qenë në dispozicion 24/7, kështu që vështirë se mund të përparoja.

Ndonjëherë shkalla e përgjegjësive në punë linte kohë të pamjaftueshme për ndonjë aktivitet tjetër jashtë punës. Shkoj në mëngjes dhe kthehem në mbrëmje

Kam humbur shumë mundësi të punës sepse nuk kishte kush të kujdesej për fëmijën tim nëse unë dhe burri im duhej të shkonim së bashku në terren.

Vazhdimisht isha e zënë, fëmijët e bëjnë të madhe se nuk kaloj më shumë kohë me ta, redaktorët e bëjnë të madhe se nuk jam gjithmonë në dispozicion. Eh, askujt nuk po i bjen tamam

Pas kthimit nga pushimi i lehonisë, punëdhënësi më zbriti në dy pozita, më uli pagën dhe m'i anuloi përfitimet, kështu që nga një pozicion i lartë drejtues u ktheva në pozicionin ku kisha qenë si fillestare

Bashkëshorti ishte kundër asaj që unë të punoja, në një rast ma solli foshnjen dhe e la në redaksi, e mora me vete në terren.

Ndërsa kolegët dhe koleget e tjera ndërtonin karrierat e tyre dhe mund të udhëtonin shumë më shpesh dhe t'u përgjigjeshin të gjitha detyrave, unë kujdesesha për tre fëmijë dhe për shkak të pagës së ulët më duhej të punoja edhe si profesioniste e lirë.

Doja të avancohesha (seminare, udhëtime studimore...), por nuk munda ta bëja këtë për shkak të obligimeve që nënkupton mëmësia. Nuk pendohem, thjesht po e them.

Pushimi i lehonisë ndikoi para së gjithash në uljen e vetëbesimit tim në jetën time profesionale. Kisha përshtypjen se bëra një pauzë shumë të gjatë, gjatë së cilës po ndodhnin shumë gjëra dhe se nuk mund t'i kapja lehtë ngjarjet.

Nuk mund të përcillja ngjarje të caktuara dhe të rëndësishme sepse fëmijët e mi p.sh. ishin të sëmurë në atë moment.

Gazetaria është një profesion në të cilin nuk ka turne apo ditë pushimi. Gazetari është gazetar kudo dhe në çdo kohë. Nuk mund të isha më ajo gazetare kur më lindën fëmijët. Më duhej të flija kur fëmija flinte, dilja nga puna kur fëmija ishte i sëmurë... Këto janë të gjitha gjëra që redaktorët i regjistrojnë diku.

Kur një person është “në njëqind anë” nuk është i dobishëm për askënd

Nuk mund të isha në çdo vend, sepse kisha dhe kam fëmijë. Tani ajo është rritur, por për 10 e ca vitet e para si nënë beqare, ti ke përgjegjësi që nënat e tjera nuk i kanë.

Dhe kur jam në shtëpi duhet të përcjell lajmet, nuk mund t’u përkushtohem fëmijëve

Nuk pata kohë dhe forcë për t’iu përkushtuar më shumë punës kur djali i im ishte i vogël. Ishte pikërisht kjo periudhë kur kolegët e mi (të së njëjtës moshë) u avancuan dhe bënë emër.

Kolegët gradoheshin gjithmonë, disa me më pak arsimim se unë, sepse pinin me drejtorin dhe rrinin kot me ditë të tëra.

Pas angazhimit tim të parë profesional mbeta shtatzënë dhe pas pushimit të lehonisë askush nuk donte të më punësonte në këtë profesion. Fillova të merrem me marketing në internet dhe meqë është krijuar një boshllëk i madh, tani kam shumë vite dhe do të shtoja njohuri, por pak përvojë në redaksi për mungesë të dhënies së mundësisë.

Në gazetari duhet ta dëshmosh veten vazhdimisht– fillimisht je i ri dhe pa përvojë, pastaj je me përvojë por je ende i ri dhe pritet të qëndrosh në punë më shumë se orari i caktuar i punës dhe se je gjithmonë në dispozicion për të gjithë. Të vendosësh të kesh fëmijë dhe të marrësh një vit pushim nga puna dhe më pas të kthehesh - e gjithë kjo jo vetëm që ngadalëson avancimin, por edhe të kthen disa hapa prapa.

Ndjej se duhet të jap shumë më tepër se kolegët e mi që nuk kanë fëmijë. Kur fëmija është i sëmurë, ndonjëherë punoj me iniciativën time nga frika se mos më pushojnë nga puna, kështu që shpesh digjem. Ndonjëherë e kam të vështirë të balancoj punën dhe prindërimin.

Babai im ishte në spital, ndërsa unë në protesta, kështu që në marrëveshje me një koleg, arrita të shkoj akoma 15 minuta në spital. Qëndrova jashtë orarit dhe anulova kafën me miqtë e mi.

Nuk arrij t’i përkushtohem familjes dhe miqve të mi. Ne mezi e shohim apo dëgjojmë njëri-tjetrin.

Përvjetorin e parë të martesës e kalova duke raportuar nga protestat. I kam zhvendosur udhëtimet dhe pushimet për shkak të punës...

Në redaksinë e mëparshme kam punuar nga 13-14 orë, kjo ishte një nga arsyet e divorcit. Për shkak të të ardhurave jashtëzakonisht të ulëta dhe punës në të zezë, mu desh të abortoja sepse nuk doja të krijoja një rast social nga vetja dhe fëmija.

Ndonjëherë punoj gjithë ditën e mbyllur në një dhomë, ndonjëherë gjatë fundjavës, dhe ata rreth meje jetojnë të ndarë nga unë.

Shumë gjëra që nuk i arrij në punë, por priten nga unë, duhet t'i bëj jashtë orarit të punës.

Dhe puna ime përfshin punën në punë por edhe punën nga shtëpia. Kur punoj nga shtëpia, humbas kohën që do t'ia kushtoja fëmijës tim. Gjithashtu, programi live (drejtpërdrejt) që bëj gjatë punës është shpesh aq stresues sa nuk kam energji për asgjë pasdite.

Ndërprerja e lidhjeve për shkak të udhëtimeve të shpeshta. Puna jashtë orarit ka sjellë probleme me rezistencën ndaj insulinës, me probleme të shumta shëndetësore. Ndodhi që nuk e shihja familjen për javë të tëra, familjen time të gjerë për muaj të tërë për shkak të punës jashtë orarit. Kjo ndikoi në jetën time sociale dhe emocionale. E gjithë kjo në dy vitet e para të karrierës time.

Unë nuk kam orar të caktuar pune. Ndonjëherë më ndodhte që për shkak të punës më duhej të largohesha urgjentisht nga një drekë familjare ose ndonjë mbledhje tjetër. Gjithashtu, ndonjëherë mund të qëndroja në punë gjatë gjithë ditës dhe deri vonë natën. Por kjo është puna, nuk më pengon as mua dhe as familjes time

Ndonjëherë, thjesht për shkak të punës, nuk mund të merrja pjesë në ndonjë festë apo ngjarje, por ndodh, nuk mendoj se kjo punë është e ndryshme në krahasim me asnjë tjetër në atë kontekst.

Unë shkoj në një detyrë të punës, fëmijët, burri, i dashuri tërbohen që nuk jam me ta

Punoj çdo fundjavë, më mungojnë daljet, takimet familjare, festat, të cilat ndodhin gati gjithmonë në fundjavë.

Pas kthimit nga pushimi i lehonisë, meqenëse jetoj 100 km nga puna, shkoja në punë në mëngjes, kthehesha në mbrëmje dhe fëmijën tim njëvjeçar e shihja vetëm një orë në ditë.

Punoja fundjavave, puna nuk ishte prej orës 9 deri në 5 dhe orari i punës ndryshonte shpesh. Përveç kësaj, edhe studioja, kështu që pas punës studioj, është shumë e vështirë të përshtatem me njerëz që kanë orare më normale.

E kuptova që më së shumti shoqërohem me njerëz që janë në gazetari, sepse vetëm ata e kuptojnë plotësisht pse nuk mund të shihen shpesh.

Punoja në turne/ndërrim të natës dhe fëmija ishte 4 muajsh

Nisur nga temat që trajtoj, dhuna ndaj gruas në radhë të parë, por edhe afatet që duhen respektuar, më ka ndodhur që të punoj 12 orë dhe më pas shëndeti im mendor të kërkojë shtrimin e detyruar në spital.

Në planin afatgjatë, kjo mënyrë jetese më shkaktoi probleme të shumta shëndetësore, si në aspektin fizik ashtu edhe në atë mendor.

Për shkak të rrogës së ulët u detyrova të punoja nga dy-tre punë

Unë punoj në programin e mëngjesit, zgjohem në orën 4 të mëngjesit, shkoj në shtrat jashtëzakonisht herët dhe nuk mund të shkoj në një koncert, ndonjë shfaqje teatrale dhe për këtë arsye i shoh rrallë miqtë e mi, nuk përshtatem në orar.

Pak kohë i kushtoja familjes time. Sot e di që duhet të ishte ndryshe, por ato ishin vite të paqëndrueshme. Të gjithë ishim ndiqim lirinë dhe dëshirën për të mbijetuar.

Gjatë demonstratave të viteve 96/97 shkoja në shtëpi vetëm për një kohë të shkurtër për të luajtur me fëmijët, të cilët në atë kohë ishin të vegjël. Ose, le të themi, nga një pushim veror familjar, shkova të raportoja për një takim ndërkombëtar të rëndësishëm pas konfliktit

Unë thjesht nuk kam kohë. Asnjëherë nuk kam kohë. As për veten dhe as për të tjerët

Në çdo drekë familjare, është një laptop pranë meje...

Gjithmonë përpiqem t'i respektoj fëmijët e mi, por i kam lënë pas dore miqtë e mi, sepse jo gjithçka mund të përshtatet.

Ndonjëherë për shkak të punës sime nuk i shoh as prindërit për disa ditë

Shpesh shkojmë me pushime ndaras, për shkak të punës

Vëllai im i ndjerë ishte shtrirë në spital në pritje të operacionit kundër kancerit, dhe unë, e çoroditur, fillimisht shkova në redaksi për të mbaruar punën time dhe më pas për ta vizituar vëllain tim. Një herë isha në spital, por kërkoja të më lironin herët sepse kisha një intervistë të planifikuar me një drejtues rajonal.

Nuk munda të shkoja në dasmën e motrës sime, pasi që ato ditë ishin zgjedhjet dhe kishte trazira.

Mungova në ditëlindjen e parë të djalit të motrës time për shkak të një ngjarje kulturore. Në fund, tezja u fal që mungoi në atë ngjarje, por tezja nuk kishte asnjë dilemë se ku duhej të ishte atë ditë.

Që kur u bëra redaktore, kam 3 herë më shumë përgjegjësi. Mendoj se nuk flitet sa duhet për problemet e redaktoreve.

Nga të dyja anët ka viktima. Ndonjëherë të mungon një takim brezash, herë një ditëlindje dhe ndonjëherë shansi për të fituar një çmim, sepse duhej të ishe prind ose të shkoje në një festë ditëlindjeje.

Shpesh e sjell punën në shtëpi, ndaj mungoj dhe jam nervoze derisa të kryhet.

Nuk mund t'i përcjell të gjitha planet e miqve të mi dhe rrallë pranoj ftesa për kafe/darkë

Puna ishte prioriteti im deri vonë. Prandaj sakrifikova krijimin e një familjeje. Më vjen keq pa masë.

Kam munguar shumë në jetën e familjes dhe miqve të mi. Disa u larguan në atë proces e sipër.

Familja ime gjithmonë ma ka zënë për të madhe që e kam vënë karrierën time në plan të parë dhe nuk i kam kushtuar vëmendje të mjaftueshme asaj.



Shpesh zgjedh të rri në shtëpi, që të mos mendoj se kush më ka parë dhe me kë, kush janë njerëzit e rinj që vijnë. Unë kam probleme të relaksohem sepse shpesh mendoj se dikush po më shikon.

Nuk mbaj mend kur kam dalë me miqtë dhe familjen. Gati kurrë nuk shkoj me pushime me familjen time. Gjithmonë jam shumë e lodhur.

Shpesh, për shkak të mungesës së parave dhe të ardhurave adekuate, si dhe për shkak të volumit të madh të punës, nuk mund t'i siguroja vetes kushtet për të jetuar në mënyrë të pavarur, jashtë shtëpisë së familjes time ose të ndaja kohë të mjaftueshme për veten dhe jetën time sociale, etj..

PORTRETI I GRAVE NË MEDIA: “AS QË E VËREJNË SE NUK JANË TË PRANISHME”

Kur bëhet fjalë për përfaqësimin e grave në media, statistikat janë plotësisht në përputhje me gjetjet globale: gati gjysma e të anketuarave vlerësojnë se gratë janë më pak të përfaqësuara se burrat, 38.2 mendojnë se gratë dhe burrat janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe 15.7 përqind e atyre që mendojnë se burrat janë më pak të përfaqësuar se gratë. Tre të katërtat e të anketuarave thonë se përfaqësimi i barabartë në media është i rëndësishëm dhe nja 66 përqind e lakmueshme e marrin këtë parasysh në punën e tyre - për shembull kur zgjedhin bashkëbiseduesin. Në këtë kuptim, është një gjetje e papritur që gati gjysma e të anketuarave nuk shohin një kushtëzim të ndërsjellë mes statusit të grave në redaksi dhe imazhit dhe përfaqësimit të grave në media.



18

Në punën tuaj, a i kushtoni vëmendje përfaqësimit të barabartë (p.sh. Kur i përzgjedhni bashkëbiseduesit)?

33.7%
Jo



66.3%
Po

19

A ndikon statusi i grave nëpër redaksi në atë se si dhe se sa do të përfaqesohen gratë në media?

45.4%
Jo



54.6%
Po

Dëshmitë:

Redaksitë kryesisht janë po aq patriarkale sa shoqëria në tërësi. Shumica e shohin rolin e burrave/grave me stereotipe

Nuk është njësoj se kush dhe si e mbulon një temë të caktuar, sepse në këtë shoqëri burrat ende nuk e pranojnë se gratë janë në një pozitë më të keqe në çdo kuptim dhe nuk mund të pritët që të raportojnë objektivist për diçka që nuk e besojnë.

Trajtimi i keq i grave nëpër redaksi vjen nga të njëjtët njerëz që marrin vendime në lidhje me politikat editoriale

Nëse ka më shumë gra në media dhe në poste të larta, gruaja “e zakonshme” merr sinjalin se edhe ajo mund të ketë sukses në profesionin e saj dhe se ka vend për gratë në të gjitha sferat...

Ka kolege gra që absolutisht nuk janë të sensibilizuara për tema të caktuara dhe nuk i shohin si problem komentet seksiste dhe diskriminuese të kolegëve meshkuj dhe as nuk kanë nevojë për balancim kur bëhet fjalë për bashkëbiseduesit. Nëse nëpër redaksi ka gazetare femra që janë të vetëdijshme në këtë drejtim, ai balanc do të shihet në program, nuk ka rëndësi nëse janë redaktore apo thjesht gazetare pa ndonjë funksion menaxherial.

Nëse nuk ka ndërgjegjësime për barazinë gjinore në media, përmbajtja e asaj media do ta pasqyrojë atë. Nëse barazia gjinore nuk do të ketë mbështetjen e redaksisë dhe të menaxhmentit, kjo do të ndikojë në statusin e grave në redaksi, si dhe në përfaqësimin e tyre në media. Gjithashtu, problemet ekzistenciale të gazetareve femra (kontrata e pasigurt, të ardhurat e ulëta, atmosfera armiqësore në punë, etj.), ndikojnë në përfshirjen e tyre kur bëhet fjalë për çështjet e barazisë gjinore. Duhet shumë guxim të luftosh për tema që nuk konsiderohen të rëndësishme nëpër redaksi dhe madje mund edhe të përqeshen.

Burrat nuk mendojnë kështu, jo sepse janë domosdoshmërisht shovinistë, por sepse këto tema nuk janë në agjendën e tyre. Ata në përgjithësi nuk shohin pabarazi gjinore.

Temat që konsiderohen të rëndësishme në nivelin e redaksisë janë të rëndësishme për atë këshill të redaksisë. Nëse ai është kryesisht mashkull apo nëse ka vite në redaksi një kulturë dominuese mashkullore, temat janë në thelb ato që u interesojnë meshkujve.

Nuk mendoj se kjo ka të bëjë me gjininë, është individuale

Ato nuk janë në poste drejtuese, dhe nëse janë, janë në duar dhe nën diktatin e burrave

Kohët e fundit në media ka vërtet më shumë femra sesa meshkuj dhe kjo, besoj, ka sjellë një pozitë më të mirë të femrave në përgjithësi.

Statusi i dobët i gazetareve femra në redaksi gjeneron gjithashtu statusin e dobët të grave në ato media

Askush nuk mund të jetë aq hipokrit sa të sillet i përgjegjshëm në aspektin gjinor në media, dhe të kundërtën ta bëjë në shtëpinë mediale. Është e pashmangshme që diskriminimi të përhapet në mesazhe publike dhe të ketë një ndikim negativ në shoqëri.

Gratë që shohim në TV, emisione, podcaste ndikojnë në mënyrë të pandërgjegjshme tek të gjitha gratë që i shikojnë ato. Secila prej tyre thotë - Hej, këtë mund ta bëjë, edhe unë!

Çdo dalje në media ndikon në publik. Unë mendoj se me paraqitjen e grave dhe gazetareve në media, në mënyrë të pandërgjegjshme i dërgohet një mesazh audiencës se ne jemi këtu dhe se aty e kemi vendin.

Më duket se mediat në të cilat gazetaret dhe prezantueset kanë për detyrë të jenë “dekor zbukurues” propagandojnë të njëjtën gjë tek lexuesit/shikuesit e tyre...

Vërej sjellje të ndryshme të bashkëbiseduesve ndaj meje kur e dinë që jam redaktore dhe ndaj kolegës sime gazetare.

Nëse gratë janë të marginalizuara, ato janë të padukshme. Dhe pastaj ata nuk e kanë trajtimin e duhur dhe as roli i tyre nuk është adekuat.

Redaktorët janë kryesisht burra. Për shkak se kanë më shumë respekt për njëri-tjetrin, tolerohen gjëra që nuk u falen grave. Gratë janë të mirëseardhura, por më shumë si një lloj mbështetjeje për pjesën mashkullore të redaksisë, jo si bartëse dhe pjesëmarrëse proaktive.

Tendenca historike është që burrat të kenë përparësi ndaj grave në Ballkan. Kur një redaksi drejtohet nga një burrë, ajo redaksi trajtohet ndryshe nga ajo që drejtohet nga një grua.

Kur e zgjedh një bashkëbisedues e shikoj ekspertizën, e jo gjininë. P.sh. në fushën e psikologjisë ka më shumë bashkëbiseduese gra, në fushën e shëndetësisë njëlloj, por problemi është se ka pak bashkëbiseduese në fushën e analizës politike.

Kolektivët e grave në media janë të padurueshme.

Ato që shfaqen në media shpesh reflektojnë mbi shoqërinë dhe shoqëria jonë tashmë është mjaft diskriminuese.

Gjithmonë përpiqem të ftoj një grua që të jetë bashkëbiseduesja ime. Megjithatë, nuk është vendimtare për mua. Unë zgjedh bashkëbiseduesit më të mirë për temën, nuk i zgjedh në çelësin e barazisë gjinore.

Publiku, madje as vetë gratë, nuk e vërejnë se nuk janë të pranishme, pra se janë më pak se burrat.

Gazetaria si profesion mundëson barazi absolute gjinore dhe kjo as që duhet të bëhet fjalë

Meshkujt janë (edhe pse nuk duket ashtu) bashkëbisedues krejtësisht të parëndësishëm për shumicën e temave që i shqetësojnë femrat. Për disa arsye, burrat përdoren si figura autoriteti (figura mjekësh, priftërinjsh, avokatësh, gjyqtarësh), ndërsa gratë rrallëherë janë në një rol eksperti - më shpesh ato flasin për përvojën personale, përfaqësojnë një institucion ose role stereotipe femërore - kujdestare, etj. Kjo e deformon imazhin e tyre para publikut.

Ndodh që mediat flasin për tema që kanë të bëjnë kryesisht me femra (p.sh. aborti), e më pas sjellin meshkuj të ndryshëm për të folur për këtë. Për shembull, TV Prva është shembull për këtë. Ose sjellin një grua dhe një burrë, dhe ajo ka shumë më pak kohë për të folur se ai, ose ai e sulmon/diskrediton atë gjatë gjithë kohës.

Kur një vajzë e vogël sheh një grua të suksesshme në TV, ajo mund ta shohë atë në një mënyrë shumë më domethënëse sesa që është e mundur nëse i sheh vazhdimisht burrat si bashkëbisedues të suksesshëm dhe të rëndësishëm. Në të gjithë botën, përfaqësimi ka treguar një lidhje të qartë me të ashtuquajturat modele, të cilët u tregojnë fëmijëve se çfarë mund të bëjnë nëse e shohin dikë të ngjashëm me ta në TV apo në media në përgjithësi. E njëjta gjë vlen edhe sa i përket moshës, vajzat e reja u drejtohen njerëzve të një moshe të ngjashme, gratë që janë në të 50-at më shpesh duan të dëgjojnë mendimet e grave të një moshe të ngjashme. E njëjta gjë vlen edhe për fenë, racën, kombësinë, grupet minoritare. Modeli i “serbit mashkull ortodoks” është figurë absolutisht dominuese në media dhe figurë që nuk mund të jetë model për të gjithë.

REKOMANDIME

1. Vendosja ose përmirësimi i linjave telefonike ndihmëse dhe i sistemeve të ndihmës juridike në shoqatat e gazetarëve (për t'i inkurajuar gratë e angazhuara në media që t'i raportojnë rastet e dhunës).
2. Përmirësimi i bashkëpunimit me rrjetin e mentorimit të Këshillit Britanik (në mënyrë që gratë e reja të kenë mundësi të kërkojnë këshilla, të konsultohen për kushtet e punës dhe mjedisin e punës).
3. Të ftohen fakultetet, partitë politike, institucionet dhe organizatat joqeveritare që të përcjellin në media të dhënat kontaktuese të grave që mund të jenë bashkëbiseduese në raportazhe të ndryshme mediale.
4. Të ftohen gratë e angazhuara në media që të anëtarësohen në ndonjë nga shoqatat apo grupet mediatike të tipit “Gazetaret kundër dhunës”: nga njëra anë, kjo do t'i fuqizonte ato, ndërsa nga ana tjetër, do t'i frymëzonte ato që t'i inicionin masat që mund ta përmirësojnë statusin e tyre.
5. Të iniciohet, në rrjetet sociale, krijimi i grupit Gratë në Media - ku gazetaret, kameramanet, montazheret, fotoreporteret, të mund të ankohen, të informojnë dhe të ndërliken në rrjet.

MIRËNJOHJET

Anketa për Pozitën e Grave të Angazhuara në Mediat Serbe është realizuar falë gatishmërisë, përkushtimit dhe kohës së 401 gazetareve, redaktoreve, producenteve, fotografeve dhe prezantueseve gra, të cilat punojnë nëpër platforma të ndryshme mediatike në Serbi.

Ato, në mënyrë anonime, i ndanë përvojat dhe njohuritë e tyre, duke na dhënë mundësinë që për herë të parë të krijojmë një pasqyrë më të saktë të stërmundimeve, përpjekjeve dhe sfidave të tyre brenda redaksive e më gjerë.

Kontributi i tyre i thellë dhe i sinqertë do të shërbejë si dëshmi e rëndësishme nga e cila ne të gjithë mund ta fillojmë diskutimin për atë se “Si është të jesh grua në mediat serbe?”

METODOLOGJIA

Ne përdorëm vetëm një mjet ankete online për hulumtimin tonë për të vlerësuar përfaqësueshmërinë e pikëpamjeve, qëndrimeve dhe të përvojave individuale, si dhe për të analizuar nëse ose si kryqëzohen këto të dhëna, për të përcaktuar dhe konfirmuar realitetet që i rrethojnë gazetaret gra dhe implikimet që ato kanë në vendin e tyre të punës. Me këtë anketë jemi përpjekur t'i shqyrtojmë rrethanat në të cilat punojnë ato nga perspektiva gjinore.

Me anketën që përbëhej nga 40 pyetje, jemi përpjekur t'i përcaktojmë aspektet e mëposhtme:

- Ndërtimin e profilit të një gazetareje mesatare serbe
- Fushat dhe temat të cilat mbulojnë
- Gjendjen financiare
- Kushtet në vendin e punës
- Diskriminimin gjinor në vendin e punës
- Dhunën seksuale në vendin e punës
- Zbatimin e Ligjit të Punës, veçanërisht të nenit të Pushimit të Lehonisë
- Stërmundimet e gazetareve që janë kujdestarë të familjes
- Reflektimet personale mbi barazinë gjinore dhe diskriminimin në vendin e punës
- Reflektimet mbi portretizimin mediatik të gjinisë

Anketa arriti të 734 gra punonjëse të medias anembanë Serbisë. Anketës iu përgjigjën 401 herë - 189 gra u janë përgjigjur të gjitha pyetjeve, ndërsa 219 sosh u janë përgjigjur vetëm pyetjeve që nuk kërkojnë shpjegime shtesë. Një numër sosh me dashamirësi refuzuan t'i ndajnë historitë e tyre personale. Megjithatë, kjo nuk ndikon në statistikat e përfituara, pasi që këtu përfshihen vetëm pyetjet në të cilat janë përgjigjur të gjitha.

RRETH ALVED-IT

Fuqizimi i zërave lokal për zhvillim të barabartë (ALVED) është një projekt 30-mujor i financuar nga Fondi i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për Konfliktet, Sigurinë dhe Stabilitetin dhe i zbatuar nga një konzorcium organizatash i përbërë nga Peaceful Change initiative (Iniciativa për Ndryshim Paqësor), People in Need (Njerëzit në nevojë), Iniciativat Qytetare (Civic Initiatives, Serbi), Peer Educators Network dhe Aktiv (të dyja nga Kosova). Ky projekt synon të promovojë, eksplorojë, zhvillojë dhe zbatojë praktika inovative që mundësojnë vendimmarrjen pjesëmarrëse që është e suksesshme në kapërcimin e pengesave ndërmjet grupeve të ndryshme në Serbi dhe Kosovë, si dhe t'i angazhojë palët e interesuara të projektit në analizimin e kontekstit në të cilin zhvillohet kjo punë me një pikëpamje për të ndërmarrë veprime bashkëpunuese dhe strategjike për të kontribuar në një mjedis më të favorshëm për lulëzimin e demokracisë gjithëpërfshirëse dhe për të pasur një ndikim pozitiv në jetën e njerëzve të rëndomtë.



Ky studim është financuar nga UK AID prej Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, megjithatë, pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

RRETH PCI

Iniciativa për Ndryshim Paqësor (PCI) punon bashkë me shoqëritë për ta parandaluar ose zvogëluar dhunën që shkaktohet nga ndryshimet radikale dhe përçarëse. Ne synojmë t'i zbusim efektet e dhunës në jetën e njerëzve, duke i ndërtuar themelet për paqen dhe stabilitetin afatgjatë.

Ne drejtojmë programe në Lindjen e Mesme (Siri), Afrikën Veriore (Libi) dhe Evropë (Ukrainë, Ballkanin Perëndimor, Kaukazin Jugor). Puna jonë fokusohet në:

- Forcimin e aftësive të liderëve lokalë dhe kombëtarë të cilët janë në gjendje të ndërtojnë marrëdhënie përtej ndasive të konfliktit;
- Mbështetjen e liderëve lokalë dhe aktivistëve të shoqërisë civile në veprime praktike për ta zvogëluar dhunën dhe për ta përmirësuar ndjenjën e sigurisë së komuniteteve;
- Nxitja e partneriteteve të punës ndërmjet komuniteteve dhe autoriteteve lokale, si dhe ndërmjet grupeve të ndryshme lokale dhe kombëtare përtej ndasive të konfliktit, për ta ndërtuar besimin në një të ardhme të përbashkët;
- Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile për t'u lidhur, shkëmbyer përvoja dhe për të qenë pjesë e vendimmarrjes;
- Zhvillimi dhe shkëmbimi i mjeteve dhe metodologjive praktike për ndërtimin e paqes;
- Këshillimin e agjencive, OJQ-ve, qeverive dhe kompanive ndërkombëtare për mënyrën si të arrihet një ndikim më i madh.



Peaceful
Change
initiative

Peaceful Change initiative

peacefulchange.org

UK Headquarters, 25B Lloyd Baker Street, London

Charity number: 1162997



www.facebook.com/peacefulchange.org



twitter.com/pci_org



uk.linkedin.com/company/peaceful-change-initiative